



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:184922

Datë: 13.06.2023

Numri i dokumentit: 04386455

T.nr.48/04

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Shaban Shala, me sekretaren juridike F.B. në çështjen juridike të propozueses L.B. nga Prizreni rr. për shkak të shqyrtimit të trashëgimisë-pasurisë së gjetur më vonë, më datën 31.05.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET se propozimi i propozueses për shqyrtimin e trashëgimisë-pasurisë së gjetur më vonë **T.nr.48/04 dt.09.09.2004** në këtë çështje juridike, **ËSHTË TËRHEQUR**.

II.MBETET në fuqi aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prizren **T.nr.48/04 dt.25.06.2004** i plotfuqishëm më dt.26.07.2004.

III.Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesja L.B. nga Prizreni rr..... në këtë gjykatë ka parashtruar propozim për shkak të shqyrtimit të trashëgimisë-pasurisë së gjetur më vonë.

Në shqyrtimin kryesor të caktuar për datën 31.05.2023, ka marrë pjesë propozuesja personalisht e cila ka tërhequr propozimin lidhur më pasurinë e gjetur më vonë sipas aktgjykimit C.nr.297/97 dt.21.05.1997 për shkak se kjo procedurë është duke u zhvilluar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe ende nuk ka përfunduar.

Gjykata ka vendosur sikurse në dispozitivin nën II të këtij aktvendimi, pra duke lënë në fuqi aktvendimin e plotfuqishëm me të cilin është shqyrtuar trashëgimia bazë për shkak se kemi të bëjmë më propozim për shqyrtimin e pasurisë së gjetur më vonë.

Duke marrë parasysh këtë fakt gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 261 lidhur me nenin 387 par.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
-Departamenti i Përgjithshëm-
T.nr.48/04, datë 31.05.2023

Gjyqtari
Shaban Shala

Numri i lëndës: 2021:184922
Datë: 13.06.2023
Numri i dokumentit: 04386455

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.